



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 21.07.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I
NËNSTACIONEVE 110 KV HIMARË DHE ORIKUM, SI DHE ZGJATIMET E LINJAVE
35 KV”


Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me subjekt zhvillues Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i nënstacioneve 110 kv Himarë dhe Orikum, si dhe zgjatimet e linjave 35 kv”, me vendndodhje përkatësisht në Bashkinë Himarë dhe Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
2. Hartat e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues vetëm pas:
 - a) miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë e shpronësuara;
 - b) miratimit të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë;
 - c) pagesës së taksave së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të bashkive, sipas juridiksionit përkatës territorialo - administrativ.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT


LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



DAMIAN GJIKNURI
ANËTAR I KKT





DRITAN DEMIRAJ
ANËTAR I KKT

SOKOL DERVISHAJ
ANËTAR I KKT





MILVA EKONOMI
ANËTAR I KKT





GAZMEND BARDHI
ANËTAR I KKT





MIRELA KUMBARO
ANËTAR I KKT





EDMOND PANARITI
ANËTAR I KKT





LEFTER KOKA
ANËTAR I KKT





GJON RADOVANI
ANËTAR I KKT

